



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. ____ Prot

Datë ____ / ____ / 2022

NJOFTIM

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”; Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit nr. 90 dt.27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP) shpall konkurrimin për 1 (një) vend të lirë në pozicionin:

Mjeshtër Rrobaqepës pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik;

Kandidati/ja duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme, dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

- Të këtë arsim të mesëm të përgjithshëm ose profesional dhe të jetë i/e certifikuar për rrobaqepsi;
- Të këtë përvojë pune mbi 10 vjet në këtë fushë, si dhe të jetë prestar i kualifikuar, të dijë të zbërthejë skicat e operave dhe baleteve klasike etj;
- Të këtë njohuri të mira në zbërthimin në detaje të skicave, vizatimeve;
- Të njohë dhe të përdorë makinat qepëse profesionale dhe mjetet e tjera të punës të cilat kanë të bëjnë më realizimin e plotë të kostumeve të karaktereve të ndryshme;
- Të zbatojë me përpikmëri (skicat e operave baleteve) të shfaqjeve të lidhura ngushtë më profilin e punës;
- Të organizojë punën, ndarjen e punës të ndihmës mjeshtres rrobaqepëses;
- Të kryejë të gjitha përgatitjet e nevojshme për punën;
- Të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike;
- Të këtë aftësi të mira komunikimi, si dhe i aftë për të punuar në grup.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

1. Kërkesë më shkrim për pozicionin e punës së shpallur;
2. Jetëshkrimi CV;
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
4. Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara;
5. Dokument për kualifikime, dëshmi trajnimesh të ndryshme, etj (nëse ka) ;
6. Fotokopje të librezës së punës;
7. Dëshmi e gjëndjes gjyqësore;
8. Një numër telefoni si dhe adresa e plotë të vendbanimit;

*Dokumentat duhen të paraqiten në gjuhën shqipe.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim te kandidatit.

KONKURIMI: Është i hapur

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 02/09/2022.Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.